

Data 30.10.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qera mjete motorike per nevojat e shoqerise OSSH sh.a dhe FSHU sh.a ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34120000-4 - Automjete motorike për transportin e 10 apo më shumë personave

VLERA E FONDIT LIMIT:

- -672,888,000 (gjashtëqind e shtatedhjetë e dy mijë e teteqind e tetëdhjetë e tete) Leke pa TVSH ose: konvertuar ne 6,370,236 (gjashtë million e treqind e shtatedhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH bazuar ne kursin e kembimit date 30.10.2023 (1 Euro= 105.63)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a ” ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Objekti i kontrates lidhet me marrjen me qira operacionale te mjeteve motorrike te cilat kane karakteristika dhe tiplogji te njejte dhe keto automjete tregtohen nga operatore ekonomik te cilet ofrojne te gjitha kategorite e mjeteve te kerkuara.

Shoqerite OSSH sh.a dhe FSHU sh.a , bija te OSHEE Group nderveprojne mes tyre gjate veprimtarise funksionale per rrjedhoje duhet te pajisen me floten e mjeteve njekohesisht. Nje nga arsyet e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar natyres se mallit, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi do e bënte shumë të vështirë për tu menaxhuar: levrimi, dorezimi dhe administrimi gjate kohezgjatjes se kontrates.

Kjo procedurë malli duhet të kryhet nga një operator ekonomik, pasi flota e mjeteve duhet të jetë e unifikuar për të gjitha kompanite, drejtorite/njesite dhe për të qenë sa më efikase duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik edhe me qëllim ushtrimin e kontrollit dhe kërkeses së përgjegjësive gjatë zbatimit. Furnizimi nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës, por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës. Pajisja me flote e të gjitha drejtorive të rajoneve, do të mundësojë një përdorim më efikas të burimeve njerëzore dhe të kohës. Kjo do të lejojë që stafi i caktuar për realizimin e kontratës të fokusohet në një proces të vetëm, duke e bërë atë më efikas.

Duke përfshirë të gjitha drejtoritë e rajoneve të Shqipërisë në një tender të vetëm, sigurohet që të gjitha rajonet të përdorin mjete motorike të standardizuara. Kjo do të promovojë standardizimin e mjeteve dhe do të sigurojë që secila drejtori të ketë qasje në mjete cilësore dhe të sigurta.

Duke përfshirë të gjitha drejtoritë e rajoneve në një procedurë të përbashkët siguron kushte më të mira në lidhje me çmimin dhe kushtet e përgjithshme të kontratës. Kjo gjithashtu mund të sjellë përfitime financiare në formë të uljeve në çmim për shkak të vëllimit të madh të blerjeve.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari për mbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2. 1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontratës për këtë objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të deshmonte se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros për tre vitet e fundit në një vlerë jo më e vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nën 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën

kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për të gjithë vitin 2023 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Ky kriter të permbushet nepermjet paraqitjes se formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas Shtojces perkatese te DST.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Njësia e prokurimit kerkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave të kërkuar në këto objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të këto realizuar me kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal dhe në këto menyre, AK krijon sigurine dhe besueshmerine që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurine e punës së AK.

2.4 Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese:

Certifikate ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, **OSE EKUIVALENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe nenin 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Vendosja e kriterit për operatorin ekonomik ofertues të pajisur me Certifikatën ISO 9001 për sistemin e menaxhimit të cilësisë është një hap i arsyeshëm dhe i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e punës dhe zbatimin e kontratës. Kriteri për Certifikatën ISO 9001 është i rëndësishëm për të siguruar cilësi, efikasitet dhe besueshmëri.

Së pari, Certifikata ISO 9001 tregon se operatori ekonomik është i përkushtuar ndaj cilësisë dhe menaxhimit të proceseve. Ky standard ndjek një qasje sistematike dhe të dokumentuar për të menaxhuar cilësinë në të gjitha fazat e procesit të prodhimit ose shërbimit. Përdorimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë të bazuar në ISO 9001 siguron që operatori ekonomik është në gjendje të identifikojë, monitorojë dhe korrigjojë problemet e cilësisë në mënyrë efektive.

Së dyti, ky kriter siguron që operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike të tenderit. Certifikata ISO 9001 paraqet një vërtetim të jashtëm të aftësisë së operatorit ekonomik për të kryer punën me cilësi të lartë dhe në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtare.

Së treti, ky kriter siguron që operatori ekonomik është i aftë për menaxhim të mirë të punës dhe për të zbatuar efikasitetin operacional. Një sistem i menaxhimit të cilësisë sipas ISO 9001 përfshin procedurë të dokumentuara dhe një qasje të planifikuar ndaj risqeve. Kjo ndihmon në planifikimin e mirë të furnizimit të mallrave dhe në parandalimin e gabimeve dhe dështimeve të mundshme gjatë punës.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratat/autorizimet nga prodhuesi/distributor i autorizuar, por në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për mjetet e ofruara.

ARGUMENTIM: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në kete proces. Ky kriter ka disa arsye:

Së pari, paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën konkrete. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plote të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktoje me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Së treti, kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mjeteve. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në kete proces. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me mallra të realizohet me sukses dhe pa probleme të panevojshme.

2.4.3 Me qellim krahasimin e specifikimeve teknike të ofertuara me ato të kerkuara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë katalogun/fragmentin e katalogut të mallrave me të cilat oferton.

Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

ARGUMENTIM: *katalogu/fragment katalogut i mjeteve kerkohet, me qellim krahasimin e specifikimeve te automjeteve me te cilat ofertohet, me specifikimet e autoritetit kontraktor.*

Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është një hap i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Së pari, paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth mjeteve. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë e mjeteve që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Së dyti, kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mjetet e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Fragmentet e katalogut tregojnë se operatori ekonomik ka kujdes për detajet dhe është i përkushtuar ndaj cilësisë dhe pajtueshmërisë.

Së treti, kriteri për përkthimin dhe noterizimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerjes. Përkthimi dhe noterizimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mjeteve.

2.4.4 Me qëllim riparimin e difekteve teknike të mjeteve, (ndërrime pjesësh konsumi si goma, ferrota frena, disqe frenash, fshirëse xhami, amortizator, gomina, etj.), Ofertuesi të provojë se disponon auto servis të cilin duhet t’ a kete të pasqyruar në aktivitetin e vet në QKR, ose të kete kontrata shërbimi/bashkëpunimi të vlefshme.

Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit të përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr. 8 të DST.

ARGUMENTIM: AK duhet të bindet që gjatë kohezgjatjes së kontratës operatori ekonomik ka aftësinë dhe kapacitetin për furnizimin e magazinave të tij me të gjithë materialet e nevojshme për shërbimet e mirëmbajtjes ose përfitimin e shërbimit të servisimit nga operatori të tjerë.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se me dorëzimin e mjeteve motorike objekt i procedurës së prokurimit detyrimisht do të mbulojë me shpenzimet e tij të gjitha pagesat në lidhje me:

- Tarifen e kontrollit fizik
- Tarifen e regjistrimit (targat)
- Taksat vjetore

- Pagesen per kontrolli teknik(ne rastet kur nuk perjashtohet nga(DPSHTRR)
- Pagesat per TPL dhe Kasko

Si dhe cdo shpenzim tjeter qe lidhet me mjetin (taksa lokale apo te pergjithshme, pronesia etj) per te gjithë periudhen e kontrates.

ARGUMENTIM: Ne kontratat e qirase operationale per mjetet motorike te gjitha shpenzimet qe lidhen me qarkullimin e mjetit ne infrastrukturen rrugore duhet te perballohen nga OE. Keto shpenzime perfshijne edhe pagesat qe certifikojne aftesine teknike te mjetit gjate kohezgjatjes se kontrates.

2.4.6 Operatori Ekonomik duhet te percaktoje ne oferten e tij nje liste me limitin e km per nderrim te gomave, limitin e km per zevendesimin e amortizatoreve, nderrimin e filtrave dhe vajit te motorit, si edhe te gjitha serviseve periodike te nevojshme per tu kryer ne mjetet e dhena me qera per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates, referuar specifikimeve teknike.

Shenim:Ne levrimin i mallit, për t’u siguruar që cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, furnizuesi per mallrat sipas Autorizimit te Prodhuesit ose te distributorit te autorizuar nga prodhuesi duhet te paraqese dokumentacionin sa me poshte:

1.1 Shlyerjen e te gjitha detyrimet ne lidhje me institucionet perkatese (dhe ato shitesë):, taksa rrugore / qarkullimi te vitit perkates. Per kete duhet te paraqese dokumenta origjinale

ARGUMENTIM: Ne kontratat e qirase operationale per mjetet motorike te gjitha shpenzimet qe lidhen me qarkullimin e mjetit ne infrastrukturen rrugore duhet te perballohen nga OE. Keto shpenzime perfshijne edhe pagesat qe certifikojne aftesine teknike te mjetit gjate kohezgjatjes se kontrates.

1.2 Te kete te pajisura te gjitha mjetet me Siguracion te detyrueshëm TPL si edhe Siguracion i Plotë KASKO (mbulim për vjedhje/zjarr/dëme) për gjithë periudhen e Qirasë së Plote Operacionale. Per kete duhet te paraqese dokumenta origjinale

ARGUMENTIM: Sigurimi i mjeteve motorike per demet ndaj paleve te treat eshte detyrim ligjor te cilin duhet ta plotesojne te gjitha mjetet qe qarkullojne ne territorin e Republikes se Shqiperise ne perputhje me Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit". Siguracioni i plote KASKO eshte kerkuar ne menyre qe te minimizojne riskun e demeve qe mund ti shkaktohen mjetit motorik gjate perdorimit te tij nga punonjesit e OSHEE sh.a. ne kontratat e qirave operationale te mjeteve motorike kostot e sigurimeve te mesiperme jane detyrim i OE.

1.3 Certifikatat e origjines te mjeteve.

ARGUMENTIM: kerkohet certifikata e origjines se mjeteve me qellim per te verifikuar origjinen e tyre dhe per tu siguruar mbi prodhuesin e mjeteve.

Certifikata e origjinës është një dokument që i siguron blerësit për origjinën e mjeteve motorike. Ky kriter siguron se mjeteve motorike janë prodhuar nga burime të besueshme dhe që janë në përputhje me standarde të cilësisë dhe sigurisë. Ky është thelbësor për garantimin e sigurisë së përdoruesve dhe për performancën e duhur të mjeteve motorike. Certifikata e origjinës konfirmon se mjeteve motorike janë të prodhuara nga prodhues të licencuar dhe të besueshëm, duke reduktuar rreziqet e blerjes së mallrave të cilësisë së ulët.

Nje certifikatë e origjinës eshte e detyrueshme për të garantuar që mallrat janë të zbatueshme dhe legale në tregun shqiptar. Kjo siguron që mjeteve motorike janë të ligjshme dhe në përputhje me standardet dhe rregullat e vendit.

Përfshirja e këtij kriteri në procedurën e tenderit tregon përgjegjësinë dhe transparencën e procesit. Ky kriter siguron që të gjithë ofruesit duhet të përmbushin një standard të njëjtit për origjinën e mallrave, duke garantuar një këndvështrim të drejtë për të gjithë ofruesit.

Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Në konsideratë te përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorezoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Keto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si

dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, fondi limit janë hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: